



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 15 mars 2019

Z. Avni Gashi, U.d. i drejtorit
Agjencia e Kosovës për Akreditim
Rr. "Agim Ramadani"
Qendra e Studentëve, kati i dytë
10000 Prishtinë

LETËR REKOMANDIMI

Ankesa nr. 522/2018
Leonis Gashi
kundër
Agjencisë së Kosovës për Akreditim

I nderuari z. Gashi,

Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), në bazë të nenit 16, paragrafit 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe në bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-125 për Qasje në Dokumente Publike (LQPD), më 26 korrik 2018, ka pranuar ankesë nga z. Leonis Gashi, në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Kolegjit ISPE, kundër Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA).

Ankuesi pohon se, më 6 gusht 2018, Kolegji ISPE i është drejtuar AKA-së me dy kërkesa. Kërkesa e parë ka të bëjë me heqjen e njoftimit publik për vendimet e nxjerra në Mbledhjen e 58 të Këshillin Shtetëror të Cilësisë (KShC); dhe kërkesa e dytë ka të bëjë me kërkesën për qasje në dokumente publike, përkatësisht në Procesverbalin e Mbledhjes së 58 të KShC-së, për të cilat ai nuk ka pranuar përgjigje.

Lidhur me këtë çështje, më 26 tetor 2018, Avokati i Popullit i është drejtuar me shkresë u. d. i drejtorit të AKA-së dhe ka kërkuar informacione lidhur me veprimet që i ka ndërmarrë dhe për ato që planifikon t'i ndërmerr AKA-ja, me qëllim të përgjigjes në kërkesat e parashtruar nga Kolegji ISPE. Më 13 nëntor 2018, Avokati i Popullit ka pranuar përgjigje nga AKA-ja me të cilën, ndër të tjera është njoftuar: "[...] Vendimet e KSHC-së janë bërë publike me qëllim të njoftimit të qytetarëve [...] për tërheqjen e akreditimit të programeve të studimit [...]".

[...] kjo kërkesë është trajtuar nga KSHC në mbledhjen e 59, por duke e ditur që procesverbali mban qëndrime të anëtarëve të KSHC për çështjet e caktuara, [...], KSHC këtë çështje e ka trajtuar konform nenit 10 të Ligji Nr. 03/L – 215 7 tetor 2010 [...].”

Avokati i Popullit rikujton se Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 41, paragrafi 1, përcakton të Drejtën për Qasje në Dokumente Publike: “Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike”; dhe paragrafi 2 i po të njëjtit nen, përcakton: “Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.” Ndërsa neni 55 i Kushtetutës, përcakton: “Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.”

Fryma e nenit 41 të Kushtetutës është përcjellë edhe në nenin 1 të LQDP-së: “Ky ligj garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje, pas kërkesës, në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuar nga institucionet publike.”

Avokati i Popullit vë në pah se kufizimi i së drejtës për qasje në dokumente publike duhet të ketë përjashtim, gjë që përcaktohet me nenin 12, paragrafi 1, të LQDP-së, me të cilin shprehimisht përcaktohen situatat për refuzimin e së drejtës për qasje në dokumente. Sidoqoftë, neni 12, paragrafi 3, përcakton mundësinë e kufizimit të ndonjë pjese të dokumentit të kërkuar, për arsyet e përmendura në paragrafin 1 të nenit 12, ndërsa pjesët e mbetura të dokumentit bëhen publike. Më tej, në rastet kur refuzohet kërkesa për qasje në dokumente publike, institucioni publik, i cili e refuzon qasjen në dokumentin në tërësi, apo pjesërisht, obligohet të nxjerrë aktvendim me shkrim lidhur me arsyet e refuzimit.¹ Për më tepër, Ligji nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDhP), në nenin 5 [Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale dhe të ndjeshme], paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, përcakton: “Përpunimi është i domosdoshëm për qëllime të interesave legjitime të ushtruara nga kontrolluesi ose pala e tretë apo palëve të cilave u janë zbuluar të dhënat, me përjashtim të rasteve kur interesat e tilla janë në kundërshtim me të drejtat dhe liritë themelore të subjektit të të dhënave.”

Avokati i Popullit vëren se mospërgjigjja në kërkesën e ankuesit, përveçse është në kundërshtim me LQDP-në dhe me LMDhP-në², bie ndesh edhe me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA), përkatësisht me parimin e administratës së hapur, të përcaktuar me nenin 9, paragrafi 1: “Organet publike duhet të veprojnë me transparencë.”

Lidhur me këtë çështje, përkatësisht kërkesën e parë të ankuesit, Avokati i Popullit konsideron se AKA-ja është dashur të veprojë në pajtim me dispozitat ligjore të LPPA-së dhe ankuesit t’i përgjigjet në kërkesën e parashtruar, pa paragjykuar përmbajtjen e saj. Ndërsa, sa i përket kërkesës së dytë të ankuesit, Avokati i Popullit konsideron se qasja në dokumentin e

¹ Ligji nr. 03/L-125 për Qasje në Dokumente Publike, neni 13 [Refuzimi i qasjes në dokumente zyrtare].

² Ligji nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, neni 22 [E drejta për qasje].

kërkuar mund të trajtohet në pajtim me nenin 11, paragrafi 2, i LQDP-së dhe me nenin 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, të LMDhP-së.

Me qëllim të përmirësimit të respektimit të së drejtës për qasje në dokumente publike, si e drejtë kushtetuese dhe ligjore, në mënyrë që qytetarët ta shfrytëzojnë këtë të drejtë, si mjet të fuqishëm për kontrollin e punës së organeve të pushtetit, e që do të ndikonte në përmirësimin e punës së organeve shtetërore, rritjen e transparencës dhe të llogaridhënies, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe me nenin 27 Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, i:

Rekomandon

Agjencisë së Kosovës për Akreditim

- *Ta trajtojë kërkesën e Kolegjit ISPE për qasje në dokumente dhe t'i përgjigjet atij, në pajtim me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike dhe me legjislacionin përkatës në fuqi.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, (...) duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi që të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,


Hilmi Jashari

Avokat i Popullit